

UDHËZUES PËR SUKSES

KODI I SJELLJES SË PMI-SË



LETËR NGA DREJTORI YNË EKZEKUTIV

Të dashur kolegë,

Ne në PMI jemi të bashkuar nga qëllimi i përbashkët për arritjen e transformimit të biznesit që ndryshon industrinë. Kjo është një kohë ngazëllyese për PMI dhe jam krenar që kam nderin të udhëheq kompaninë tonë drejt arritjes së vizionit tonë për një të ardhme pa tym.

Siç e dini, përpjekje ambicioze si këto, kanë sfidat e tyre – transformimi kërkon marrjen përsipër të rreziqeve, përballjen me pasigurinë, disa herë dhe pranimin e dështimit. Fatmirësisht, tek PMI, gjithashtu – dhe madje më e rëndësishmja – jemi të bashkuar nga përkushtimi ynë ndaj pajtueshmërisë, etikës dhe ndershmërisë, që dokumentohet zyrtarisht këtu tek Udhëzuesi për Sukses i PMI-së, Kodi i Sjelljes sonë.

Përgjatë përpjekjeve të transformimit të PMI-së dhe përtej, është e rëndësishme që, kur përballemi me sfida, të vazhdojmë të mbështetemi tek vlerat tona thelbësore të ndershmërisë, respektit dhe paanësisë. Kostoja e kompromentimit të vlerave tona thelbësore është e lartë: rreziqojmë të humbasim besimin që kemi fituar ndaj njëri-tjetrit, konsumatorëve tanë, aksionerëve tanë dhe komuniteteve tona. Prandaj, presim rezultate të shkëlqyera të përfuara vetëm në pajtueshmëri të plotë me tekstin dhe frymën e ligjeve e rregulloreve të zbatueshme, praktikave tona të brendshme dhe vlerave tona.

Ky Kod paraqet parimet tona dhe përvijon rregullat dhe udhëzimet që duhet të ndjekim tek PMI. Nëse keni ndonjë pyetje ose shqetësim lidhur me Kodin tonë, ju lutemi kontaktoni menaxherin tuaj, partnerin tuaj P&C të biznesit ose partnerin tuaj të Etikës & Pajtueshmërisë.

Ju falenderojmë për angazhimin tuaj të vazhdueshëm ndaj pajtueshmërisë, etikës dhe ndershmërisë tek PMI.

Sinqerisht,



Jacek Olczak




TABELA E PËRMBAJTJES

Letër nga Drejtori ynë Ekzekutiv

02 Idetë kryesore

Praktikat tona

- 06 Ngritja e problemeve
 - 08 Integriteti në vendin e punës
 - 10 Marketingu dhe shitjet
 - 12 Konkurrenca
 - 14 Politika kundër ryshfetit dhe korrupsionit
 - 16 Mbrojtja e informacionit
 - 20 Deklaratat dhe të dhënat e kompanisë
 - 22 Integriteti shkencor
 - 24 Çështjet fiskale dhe të tregtisë
 - 26 Konflikti i Interesit, dhuratat dhe argëtimi
 - 28 Përgjegjësia e zinxhirit të furnizimit
-

30 Përgjegjësitë e Përgjegjësit

32 Zbatueshmëria dhe zgjidhja



IDETË KRYESORE



Çfarë bëjmë

Reflektojmë përpara se të veprojmë. Vendimet tona duhet të konfirmohen në të ardhmen. Përpara se të ndërmarrin veprimin përfundimtar, pyesim veten nëse ajo që po planifikojmë përputhet me „Mënyrën se si PMI“ bën biznes - nëse është në pajtueshmëri me:

Gjykimin e mirë etik;

Këtë udhëzues; dhe

Ligjin.

Ne nuk çedojmë me këto gjëra thelbësore. Ligjet mund të mos kenë kuptim, mund t'i sfidojmë ato, por përsëri i ndjekim ato. Konkurrentët mund të ndjekin standarte më të ulta, por përsëri i respektojmë tonat. Është po aq e rëndësishme që të kuptojmë se rregullat nuk janë të mjaftueshme; ato nuk zëvendësojnë nevojën për gjykimin e mirë etik.

IDETË KRYESORE

Si e bëjmë këtë

Gjykimi i mirë etik kërkon sinqeritet, respekt dhe drejtësi. Këto vlera të ndara etike janë pjesë e „Mënyrës se si PMI“ bën biznes. Ato na bashkojnë dhe na udhëzojnë si punonjës të PMI-së dhe janë në qendër të këtij udhëzuesi.

Ndershmëria. Çdo gjë varet nga besueshmëria: a duhet dhe a na besojnë njerëzit brenda dhe jashtë kompanisë; a veprojmë siç themi? Për të thënë atë që duket qartë, askush nuk do të punojë, të marrë këshilla, ose të blejë produkte nga dikush që i keqinterpreton faktet, ose përpiqet t'u hedhë njerëzve hi syve. E kuptojmë se besimi vjen nëse veprojmë duke mos patur asgjë për të fshehur.

Respekti. Të gjithë njerëzit dhe idetë e tyre meritojnë respekt. Respekti lidhet me dinjitetin, pranimin, dhe ndjeshmërinë. Mosmarrëveshjet, sfidat apo edhe konfliktet janë një forcë për të ecur përpara kur bashkohen me respektin, por bëhen shkatërruese kur nuk janë të tilla.

Drejtësia. Ajo që i duket e drejtë një personi mund të mos i duket e drejtë të tjerëve. Të qenit i drejtë kërkon mendimin rreth të gjithë atyre që janë të përfshirë ose të prekur nga një vendim. Të qenit i drejtë kërkon marrjen parasysh të të gjitha rrethanave me të cilat përballen njerëzit. Në disa situata, të qenit i drejtë kërkon të mendoheni thellë dhe shumë përpjekje. Do të ketë edhe paqartësi. Zbatimi i pabarabartë i rregullave është i padrejtë, sikurse është përjashtimi i njerëzve ose ideve të tyre për shkak të gjinisë, etnisë, fesë, preferencës seksuale ose faktorëve të tjerë.

Gjykimi i mirë etik kërkon që ta ndryshoni perspektivën tuaj. Ajo që mendojnë të tjerët ka rëndësi. Klientët tanë, kolegët tanë dhe shoqëria e gjerë janë të interesuar në atë që bëjmë. Secili duhet të besojë në atë që themi dhe atë që bëjmë. Përpara se të bëjmë veprimin, pyesim veten nëse veprimet tona do të ndeshen me vlerat e tyre. E pranojmë se jo të gjithë do të bien dakord me çdo gjë që bëjmë, por duhet që të jemi gjithnjë të bindur se veprimet tona janë të sinqerta, të respektueshme dhe të drejta.

Çfarë duhet të mbajmë mend

Jeta reale mund të na bëjë të mos shohim atë që kemi përpara. Presioni, lodhja dhe rutina të gjitha vendosin pengesa mbi vendim-marrjen tonë. Të gjithëve na shkapetet vëmendja dhe të gjithë kemi momente kur i shikojmë gjërat nëpërmjet syzeve rozë. Përpara se të veproni, ndaloni për një moment dhe mendoni nëse po i bëni gjërat sipas „Mënyrës PMI” - duke ndjekur këtë udhëzues, ligjin dhe duke treguar gjykim të shëndoshë etik. Ka gjithnjë kohë që të mendoheni përpara se të merrni vendimin përfundimtar.

Rregullat nuk zëvendësojnë gjykimin e mirë. Rregullat mund të veprojnë kundër qëllimit të tyre të synuar. Gjykimi i shëndoshë mbron ndaj këtyre gabimeve. Nëse një ligj ose rregulli i kompanisë nuk kanë kuptim, atëherë shpreheni mendimin tuaj në mënyrë që të bëjmë ndryshime. Kuptoni se derisa të ndodhë ndryshimi do të jemi në pajtueshmëri, edhe nëse nuk jemi dakort, për shkak se respekti ynë për sundimin e ligjit është i sinqertë.

Askush nuk i di të gjitha përgjigjet. Nuk është problem - nëse përpiqemi të gjejmë përgjigjet më të mira. Punojmë të gjithë bashkë. Flisni rreth zgjidhjeve të vështira me të tjerët. Gjykimi i shëndoshë është një aftësi që përmirësohet duke përfshirë të tjerët dhe duke marrë parasysh këndvështrimet e tyre. Kini parasysh, nuk bëhet fjalë vetëm për ne si individë; kur nuk përpiqeni të kërkonit ndihmë keni mundësinë që të na ndihmoni të gjithëve të kuptojmë.

Gabimet janë diçka për të cilat ne flasim, mësojmë nga to dhe i pranojmë. Të gjithë bëjmë gabime. Ato janë shumë të dobishme nëse personat e duhur e dinë se çfarë ka ndodhur dhe bëhen korrigjime bazuar mbi eksperiencë. Por duhet të kuptoni se ka një ndryshim ndërmjet një gabimi dhe shpërfilljes ndaj mënyrës sesi e bëjmë biznesin - shpërfilljes së ligjit, e këtij udhëzuesi ose vlerave të përbashkëta etike. Shpërfillja na vendos të gjithëve në rrezik dhe nuk ka vend këtu.

NGRITJA E PROBLEMEVE



NGRITJA E PROBLEMEVE

Çfarë bëjmë

Kur diçka mund të përmirësohet ose është e gabuar, marrim masa.

Nëse shikoni se diçka nuk po shkon mirë, duhet të flisni. Kur flisni, kompania do t'ju dëgjojë dhe do të veprojë. Është po aq e rëndësishme të flisni për të përmirësuar gjërat. Kur flisni në mirëbesim, PMI do t'ju mbështesë plotësisht.

Si e bëjmë këtë

Jepni idetë dhe përvorjen tuaj sesi duhen përmirësuar gjërat.

Nëse një kërkesë ose proces e bën më të vështirë që të punoni në mënyrë efikase ose duket shumë i ndërlikuar për qëllimin, atëherë vëreni në dukje. Rregullat dhe proceset duhet të kenë kuptim dhe duhet t'ju ndihmojnë që të bëni punën tuaj. Duhet të flisni edhe nëse mendoni se nuk janë marrë masat për të mbrojtur kompaninë nga një rrezik i mundshëm biznesi, ligjor ose rregullator.

Bëni pyetje kur gjërat nuk janë të qarta. PMI na ofron të gjithëve, në çdo nivel të organizatës, mundësinë e kolegëve që mund t'i përgjigjen pyetjeve, të zgjidhin probleme dhe të japin këshilla. Nëse nuk jeni të sigurt se çfarë duhet të bëni, pyesni — do të merrni ndihmë.

Ndaloni gjërat që shkojnë keq. Gabime ndodhin. Kur ndodhin, është pjesë e punës tuaj që të ndihmoni në ndreqjen e tyre. Nëse diçka nuk duket në rregull ose nëse duket se ky Udhëzues, një Parim dhe Praktikë ose ligji po komprometohen, e keni për detyrë që të flisni. Shpërfillja e problemit të mundshëm të etikës dhe pajtueshmërisë mund të bëjë që një problem i vogël të bëhet problem i madh, duke shkaktuar dëmtim të vërtetë ndaj bashkëpunonjësve dhe kompanisë.

Çfarë duhet të mbajmë mend

I hetojmë njoftimet e sjelljes së pahijshme të dyshuar. Departamenti i Etikës dhe Pajtueshmërisë ka punonjës të stërvitur në disa funksione për të hetuar shqetësimet tuaja. Standartet e Hetimit të PMI-së drejtojnë të gjitha hetimet e etikës dhe pajtueshmërisë dhe kemi një program për sigurimin e cilësisë pas hetimit për t'u siguruar që procesi të mbetet i drejtë, i paanshëm dhe i respektueshëm.

Pyesni nëse nuk jeni të sigurtë. Nëse jeni të shqetësuar se çfarë do të ndodhë kur të flisni, flisni me administratorin vendor ose Departamentin e Etikës dhe Pajtueshmërisë. Ata mund të trajtojnë shqetësimet tuaja dhe t'i përgjigjen pyetjeve që mund të keni rreth procesit.

Si të Ngrini Probleme

Ka shumë mënyra sesi mund të ngrini probleme. Flisni me:

- Përgjegjësin tuaj ose shefin e departamentit
- Burimet Njerëzore
- Departamentin Juridik
- Departamentin e Etikës dhe Pajtueshmërisë:
 - + PMI.EthicsandCompliance@pmi.com
 - + Drejtorin Rajonal të Etikës dhe Pajtueshmërisë
 - + Shefin e Etikës dhe Pajtueshmërisë

Një Linjë Ndihme e palës së tretë për Pajtueshmërinë është e disponueshme 24 orë në ditë, shtatë ditë në javë, në të gjitha gjuhët e folura në PMI.

Kontaktoni linjën e ndihmës në internet ose me telefon. Numrat lokalë të kontaktit janë të renditur në intranetin tuaj. Pranohen thirrje me tarifë të marrësit.

Linjën e ndihmës mund ta përdorni në mënyrë anonime, përveçse kur telefononi nga një grup i vogël shtetesh ku ligjet vendore e kufizojnë një praktikë të tillë. Nëse nuk jeni të sigurtë mbi kufizimet e anonimitetit në vendin tuaj, pyesni Linjën e Ndihmës ose këshillohuni me Departamentin Juridik.

INTEGRITETI NË VENDIN E PUNËS



INTEGRITETI NË VENDIN E PUNËS

Çfarë bëjmë

Ruajmë një mjedis pune që është i respektueshëm, gjithëpërfshirës dhe i sigurtë.

Të gjithë duhet të kemi mundësi të barabarta që të kontribuojmë dhe të kemi sukses duke u mbështetur në meritat e punës tonë. Të gjithë përfitojnë kur kjo gjë ndodh.

Diskriminimi, ngacmimi dhe puna në kushte të pasigurta janë të padrejta; ato janë e kundërta e mënyrës sesi bëjmë biznes.

Si e bëjmë këtë

I marrim të gjitha vendimet që kanë lidhje me punonjësit mbështetur në merita. Mos kufizoni mundësitë e njerëzve për të kontribuar ose për të ecur përpara bazuar në moshën e tyre, përgjegjësitë për t'u kujdesur për fëmijët, aftësitë e kufizuara, grupin etnik, gjininë, shprehjen e gjinisë, orientimin seksual, fenë, shtatzëninë ose karakteristika të tjera të mbrojtura personale.

Ngacmimi nuk ka vend këtu. Trajtoni të tjerët me respekt. Mos e toleroni sjelljen fyese, poshtëruese ose abuzive. Abuzimi verbal, talljet, ngacmimet e padëshiruara seksuale, kërcënimi dhe sjellja fyese janë shembuj të sjelljes së pahijshme. Natyrisht që dhuna dhe kërcënimi me dhunë janë po ashtu të papranueshme.

Bëjeni sigurinë përparësi. Mbroni veten dhe ata përreth jush nga lëndimet duke ndjekur të gjitha rregullat e shëndetit, sigurisë dhe parrezikshmërisë së kompanisë dhe qeverisë. Njoftoni administratën tuaj për të gjitha lëndimet dhe aksidentet e mundshme. Është e pasigurtë dhe e palejueshme të punoni kur jeni në gjendje të paafte dhe kur jeni nën efektin e substancave të ligjshme ose të paligjshme, përfshirë alkoolin ose ilaçet dhe barnat e dhëna me recetë. Mos sillni armë në punë ose mos i mbani me vete ndërkohë që punoni për kompaninë, përveçse kur keni marrë autorizim specifik për ta bërë këtë sipas praktikave të kompanisë.

Çfarë duhet të mbajmë mend

Ndaloni dhe dëgjoni. Sjellja mund të jetë mosrespektuese dhe përjashtuese edhe nëse nuk synojmë që të jetë e tillë. Njerëzit ndonjëherë i fyejnë të tjerët pa e ditur dhe e turpërojnë kompaninë thjesht sepse nuk dëgjojnë ose nuk kuptojnë sesi mund të ndihen ose sesi mund të reagojnë të tjerët. Për shembull, nëse mendoni — dhe veproni — sikur jeni personi më i zgjuar në dhomë dhe sikur të tjerët nuk kanë ide të mira, mund të shfaqni mungesë respekti dhe mirëkuptimi ndaj njerëzve përreth jush. Mund t'i fyeni dhe të mos kuptoni ide të menduara mirë.

Nganjëherë njerëzit nuk flasin fare për shkak të frikës ose mbrojtjes, por ata sërish ofendohen. Mësoni të dalloni ndërmjet dikujt që toleron por vuan dhe dikujt që e mirëpret një sjellje apo veprim. Jini të drejtë ndaj të tjerëve, por kini parasysh se çfarë mund t'i thotë atyre reagimi juaj ndaj sjelljes së tyre. Nëse nuk ju pëlqen diçka, ose mendoni se dikush ju ka keqinterpretuar, thoni diçka - mos prisni që të tjerët ta marrin me mend sesi ndiheni ose çfarë donit të thoshit.

Njerëzit duhet të ndihen të lirë që të shprehen në punë. Biznesi ynë përfiton nga një gamë e gjerë metodash dhe opinionesh. Mbështesim një mjedis të shumëllojshëm dhe gjithëpërfshirës, ku të gjithë punonjësit të ndihen rehat. Të gjithë kemi nevoja dhe stile të ndryshme dhe duhet t'i rregullojmë ato në mënyrë të drejtë që t'u përshtatemi këtyre ndryshimeve.

Standartet tona zbatohen në vende që nuk janë zyra. Vendet e largëta të punës, takimet jashtë zyrave, udhëtimet e biznesit dhe veprimtaritë shoqërore të ekipit janë të gjitha vende që kanë lidhje me punën. Për shembull, rregullat kundër ngacmimit zbatohen për sjelljen në një festë dalje në pension, të organizuar jashtë vendit të punës. Në të gjitha situatat, duhet të merrni parasysh sesi sjellja juaj mund të ndikojë te kolegët tuaj dhe në reputacionin e kompanisë.

Përfaqësimi i punonjësve. Respektojmë të drejtat e punonjësve për t'u anëtarësuar ose për të mos u anëtarësuar në sindikata dhe organizata përfaqësuese që zgjedhin vetë.

MARKETINGU DHE SHITJET



MARKETINGU DHE SHITJET

Çfarë bëjmë

I reklamojmë dhe i shesim produktet tona me përgjegjësi dhe vetëm për të rriturit duhanpirës.

Markat tona janë ndër markat më me vlerë në botë. E zbatojmë krijimtarinë dhe novacionin tonë në zhvillimin dhe ruajtjen e vlerës së markës. Në të njëjtën kohë, e dimë se produktet e duhanit krijojnë rreziqe ndaj shëndetit të konsumatorit.

Prandaj, angazhohemi vetëm në veprimtari të përgjegjshme shitje dhe marketingu.

MËSONI MË SHUMË

PMI 4-C: Marketingu dhe shitja e produkteve të djegshme të duhanit

PMI 7-C: Rregullorja, zhvillimi dhe prodhimi i produkteve të duhanit

Praktikat e mira të konvertimit për IQOS

Si e bëjmë këtë

Ne tregtojmë dhe ju shesim të rriturve që konsumojnë duhan tradicional apo produkte të duhanit pa tym. Të rriturit janë në gjendje të marrin një vendim të informuar për pirjen e duhanit ose të përdorin produktet e duhanit pa tym. Produktet tona dhe aktivitetet e marketingut oseshitjes janë për të rriturit që pinë duhan ose përdorin produkte të duhanit pa tym. Kemi përgjegjësinë, si kompani udhëheqëse duhani, që të luajmë rolin tonë në parandalimin e të miturve që të përdorin produktet tona.

Informojmë konsumatorët rreth ndikimeve të produkteve tona ndaj shëndetit.

Të gjitha reklammat dhe paketimet e artikujve të konsumueshëm për konsumatorët duhet të kenë paralajmërime për shëndetin, edhe nëse ligji nuk i kërkon këto paralajmërime.

Marketingu duhet të jetë i sqartë dhe i saktë.

Informacioni ose kërkesat rreth produkteve tona në materialet tona të marketingut ose të shitjeve duhet të jenë të mbështetura në fakte. Paditë për produkte që kanë lidhje me shëndetin duhen mbështetur nga dëshmi shkencore që publikojmë.

E respektojmë ligjin. Rregullat e marketingut dhe të shitjeve shpesh janë të ndërlikuara dhe kërkojnë udhëzime për t'u interpretuar. Duhet ta bëni të ditur mendimin tuaj nëse jeni në dijeni të ndonjë veprimtarie që është në kundërshtim me ligjin ose me politikat e kompanisë.

Çfarë duhet të mbajmë mend

I gjithë marketingu duhet të kalojë nëpërmjet një procesi konsultimi. Për shkak se duhet të arrijmë një standart shumë të lartë, procesi ynë kombinon besimin dhe respektin për gjykimin dhe krijimtarinë individuale, me shqyrtimin e duhur. Gjatë shqyrtimit të marketingut të propozuar, përfshijmë njerëz nga role të ndryshme, të cilët kanë përvoja të ndryshme.

Produktet tradicionale të duhanit dhe produktet e duhanit pa tym janë produkte krejtësisht të ndryshme.

Parimet tona bazë të shprehura në „si e bëjmë“ zbatohen për të gjitha produktet, por këto parime zbatohen duke përdorur rregulla dhe procese specifike për produktet tradicionale dhe produktet e duhanit pa tym. Për shembull, PMI 4-C zbatohet për produktet tradicionale, ndërkohë që Praktikat tona të Mira për Konvertimin janë për produktet tona elektronike ngroh mos digj.

Gjithashtu, gjykojemi për veprimtaritë e palëve të treta.

Veprimtaritë e marketingut dhe të shitjeve shpesh përfshijnë palë të treta, siç janë agjencitë, mikpritësit dhe organizatorët. Veprimet e tyre pasqyrohen në kompaninë tonë po aq sa veprimet tona. Nëse punoni me palë të treta në ndonjë veprimtari marketingu ose shitje, informojini rreth parimeve tona dhe bëni kujdes ndaj gjithçkaje që komprometon vlerat tona ose shkel rregullat.

KONKURRENCA



KONKURRENCA

Çfarë bëjmë

Lulëzojmë në një treg të drejtë dhe konkurrues.

Konkurrojmë fuqishëm bazuar në cilësinë e produktit, mendimet e konsumatorit, novacion, çmim dhe mjete të tjera që nxiten nga ligjet e konkurimit. E dimë se një treg konkurrues është i mirë për biznesin dhe konsumatorët tanë.

MËSONI MË SHUMË

PMI 5-C: Konkurrenca

Si e bëjmë këtë

Veprojmë në mënyrë të pavarur nga konkurrentët tanë.

Mos e çoni nëpër mend që të diskutoni ose të bini dakort me konkurrentët për çmimet ose ndonjë temë tjetër delikate mbi konkurrencën. Nëse puna juaj kërkon që të ndërveproni me një konkurrent, merrni këshilla nga Departamenti Juridik rreth mënyrës sesi mund ta bëni këtë gjë siç duhet. Shmangni bisedat lidhur me caktimin e çmimeve, hedhjen në treg të markës, programeve të tregtimit ose tema të tjera delikate mbi konkurrencën.

Nuk ndërveprojmë me partnerët e biznesit për të përjashtuar rivalët ose për të dëmtuar konkurrencën.

Marrëveshjet me klientët dhe shitësit mund të përbëjnë problem nëse përjashtojnë rivalët ose e bëjnë më të kushtueshme konkurrencën për rivalët, ose nëse dëmtojnë konkurrencën ndërmjet shpërndarësve ose shitësve me pakicë. Në vendet ku zotërojmë një pjesë të konsiderueshme të tregut, duhet të jemi veçanërisht të kujdesshëm kur ndërveprojmë me zinxhirin e tregtimit dhe të furnizimit.

Çfarë duhet të mbajmë mend

Kryerja e punës siç duhet do të thotë të kërkonti ndihmë.

Rregullat e konkurrencës janë të ndërlikuara dhe mund të jenë në kundërshtim me intuitën. Departamenti Juridik dhe drejtuesit e filialeve e kuptojnë se çfarë është e përshtatshme për tregun tuaj dhe mund t'ju ofrojnë udhëzime. Përpara se të ndërmerrni veprime, pyesni veten nëse vendimi juaj mund të përbëjë bashkëpunim me konkurrentët ose të jetë i synuar që ta përjashtojë konkurrencën ose ta bëjë më të kushtueshme për rivalët. Nëse po, duhet të këshilloheni me administratën dhe kolegët tuaj në Departamentin Juridik.

Çdo ndërveprim me konkurrentët mund të krijojë probleme ligjore.

Shpesh mënyra më e mirë e veprimit është shmangia e kontakteve të panevojshme me konkurrentët, veçanërisht nëse puna juaj ose rrethanat mund të krijojnë qoftë edhe përshtypjen se po diskutohet vendosja e çmimeve, kushtet dhe programet e tregtisë ose çështje të tjera konkurrence. Nëse dikush fillon të flasë për tema të tilla, mbylleni bisedën. Bëjani të qartë personave rreth jush se nuk dëshironi të merrni pjesë në asnjë marrëveshje kundër konkurrencës. Më pas, kontaktoni menjëherë Departamentin Juridik.

Mënyra sesi konkurrojmë është po aq e rëndësishme sa dhe rezultatet.

Disa nga mënyrat për të shtuar vëllimin dhe fitimet thjesht nuk janë mënyra sesi bëjmë biznes. Në mënyrë të ngjashme, grumbullimi i informacionit rreth veprimtarive të konkurrentëve tanë nuk është domosdoshmërisht gjëja e duhur që duhet bërë. Lloji i informacionit dhe mënyra sesi e grumbullojmë atë shpesh u nënshtrohen kufizimeve ligjore. Punoni me avokatët tuaj vendorë për të mësuar – dhe ndiqni – ligjet vendore në fuqi.

POLITIKA KUNDËR RYSHFETIT DHE KORRUPSIONIT



POLITIKA KUNDËR RYSHFETIT DHE KORRUPSIONIT

Çfarë bëjmë

Nuk i japim ryshfet askujt, në asnjë vend dhe për asnjë arsye.

Ryshfeti dobëson shtetin e së drejtës dhe ul mirëqenien e shoqërisë. E pranojmë se refuzimi ynë për të marrë pjesë në veprimtari korruptimi mund ta bëjë biznesin më të vështirë në disa tregje, por ryshfeti është thjesht i papranueshëm në PMI.

Dhe e kemi vërtetuar herë pas here se mund t'i arrijmë objektivat tona të biznesit pa këto metoda të papranueshme.

MËSONI MË SHUMË

PMI 14-C: Bashkëveprimi me nëpunësit shtetërorë dhe partnerët e biznesit. Veprimtaria politike

Si e bëjmë këtë

Nuk ofrojmë kurrë dhe nuk japim kurrë ryshfete dhe as nuk i lejojmë të tjerët të japin ryshfet në emrin tonë. Duhet të jemi tepër të kujdesshëm kur ofrojmë diçka me vlerë – përfshirë para, dhurata, favore ose argëtime – të cilat mund të shihen si një përpjekje për të ndikuar në veprimet ose vendimet profesionale të një personi. Gjykoni mirë dhe, nëse keni dyshime, punoni me Departamentin Juridik për të kuptuar se çfarë mund dhe nuk mund të bëni.

Mos bëni pagesa lehtësuese – edhe nëse lejohet sipas ligjeve vendore apo konsiderohet normale nga kultura vëndase. Pagesat lehtësuese janë pagesa me vlerë nominale ose dhurata të vogla për nëpunësit shtetërorë në shkëmbim të përshpejtimit të një procesi ose shërbimi rutinë. Nëse mendoni se është nevoja ose nëse ndjeni presionin që ta bëni një pagesë të tillë, mos e bëni. Përkundrazi, flisni me Departamentin Juridik rreth mënyrës më të mirë për të trajtuar situatën.

Dokumentoni çdo gjë me vlerë që i jepet nëpunësve shtetërorë. Duhet që të raportoni gjithmonë dhuratat dhe argëtimet që i ofroni nëpunësve shtetërorë. Kjo do të përmbushë kërkesat ligjore për regjistrimin e saktë dhe do të ndihmojë në shmangien e perceptimeve të gabuara.

Çfarë duhet të mbajmë mend

Përpara se t'i ofroni ose t'i jepni diçka me vlerë një nëpunësi shtetëror, kuptoni kërkesat e PMI-së dhe ato vendore. Një sjellje që mund të jetë e përshtatshme në një treg, mund të jetë e paligjshme ose e papranueshme në një tjetër. Për shembull, t'i ofrosh një vakt një nëpunësi shtetëror është e paligjshme në disa shtete, por e ligjshme dhe e zakonshme në shtetet e tjera.

Çfarë ndodh nëse një ryshfet ose pagesë lehtësuese duket sikur është opsioni i vetëm? Nëse mendoni se ryshfeti është i nevojshëm ose nëse dikush ju bën presion që të jepni ryshfet, atëherë duhet ta bëni të ditur këtë gjë. Kompania do të angazhojë personat e duhur për të gjetur mënyrën e drejtë për të vepruar. Shpesh mund t'i zgjidhim problemet duke kontaktuar nivele më të larta të qeverisë ose të shoqatave të biznesit. Heqim dorë nga mundësitë e biznesit ose i rishikojmë objektivat në situata ku nuk mund ta zgjidhim problemin e menjëhershëm.

Përkufizimi i nëpunësit shtetëror mund t'ju çudisë. Duhet të bëni kujdes të veçantë kur keni të bëni me nëpunësit shtetërorë. Kjo për arsye se ligjet kanë kërkesa shumë specifike lidhur me ndërveprimet me nëpunësit shtetërorë. Nëpunësit shtetërorë përfshijnë punonjësit e qeverisjes vendore dhe kombëtare dhe kandidatët politikë. Përkufizimi mund të përfshijë edhe punonjësit e bizneseve në pronësi të qeverisë, si për shembull gazetarë që punojnë për një gazetë shtetërore ose edhe administratorët e një pike karburanti në pronësi të shtetit.

Palët e treta duhet të ndjekin rregullat tona. Çdo palë e tretë që ndërvepron me nëpunësit shtetërorë në emrin tonë duhet të ndjekë të njëjtat rregulla si ne dhe të mos paguajë ryshfete (të drejtpërdrejta ose përmes ndërmjetësve).

MBROJTJA E INFORMACIONIT



MBROJTJA E INFORMACIONIT

Çfarë bëjmë

E mbrojmë informacionin për arsye konkurrence, etike dhe ligjore.

Shumicën e kohës, ndarja e informacionit është diçka e mirë, por nganjëherë është thjesht e gabuar. Mendoni rreth informacionit që përdorni dhe mësoni detyrimet specifike që kemi në lidhje me grumbullimin, përpunimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e tij.

Si e bëjmë këtë

Mbrojeni avantazhin konkurrues të krijuar nga puna jonë e mirë. Nëse informacioni krijon një avantazh konkurrues, ose nëse një konkurrent do ta dojë atë, atëherë ka të ngjarë që informacioni të jetë sensitiv nga ana tregtare që duhet të mbrohet. Disa shembuj të informacioneve sensitive tregtare përfshijnë specifikimet për produkte dhe teknologji të reja, strategjitë e marketingut dhe çështjeve të korporatave, të dhënat e studimeve, buxhetet dhe informacione të tjera financiare.

Ruajini të drejtat e pronës tonë intelektuale.

Ka shumë mënyra sesi një ide e mirë mund ta humbasë vlerën e saj nëse nuk është e mbrojtur. Sigurohuni që të ketë mbrojtje të duhura përpara se ta ndani pronën tonë intelektuale me dikë, përfshi partnerët, jashtë PMI-së. Punoni me Departamentin Juridik për të kuptuar sesi të drejtat e autorit, patentat, markat tregtare dhe format e tjera të të drejtave të pronës intelektuale mbrojnë vlerën e ideve dhe produktit të punës sonë.

Respektoni njerëzit pas të dhënave që grumbulloni dhe përdorni.

Nuk përbën problem që anëtarët e PMI-së të grumbullojnë informacion rreth njerëzve dhe ta përdorin atë për qëllime normale të biznesit (p.sh. burimet njerëzore, marketingun dhe të tjera), por vetëm nëse ndjekim rregullat bazë për mbrojtjen e privatësisë. Rregullat kryesore janë:

1) **Specifikoni** një qëllim të qartë, legjitim dhe normal biznesi për përdorim që nuk shkel privatësinë e njerëzve pas të dhënave;

2) **Njoftojini** këta njerëz për qëllimin;

3) **Përdoreni informacionin drejtë**, mos përdorni më shumë informacion sesa është e nevojshme për të arritur qëllimin dhe fshini (ose anonimizojeni) pasi të jetë arritur qëllimi;

4) **Vendosni mbrojtje të përshtatshme** për të parandaluar përdorimin e paautorizuar;

5) **Mbajeni të saktë** dhe lejojini njerëzit pas informacionit që të kenë përdorim nëse e kërkojnë; dhe

6) **Sigurohuni** që çdo palë e tretë të jetë zotuar se do ta mbrojë informacionin në të njëjtën mënyrë sikurse dhe ne.

MBROJTJA E INFORMACIONIT

Si e bëjmë (vazhdim)

Mos merrni pjesë ose mos lehtësoni tregtimin e brendshëm.

Ju mund të keni informacion që nuk është publik, që një investitor i arsyeshëm mund ta konsiderojë të dobishëm për të vendosur nëse do të blejë ose do të shesë një aksion. Gjykimi i mirë dhe ligjet parandalojnë përdorimin e këtij informacioni për të blerë ose shitur aksione, ose „për t’u dhënë këshilla” të tjerëve (bashkëshortëve, bashkëpunëtorëve, miqve, ndërmjetësve, etj.) me këtë informacion. Grupi i Sekretarit të Korporatës së Departamentit Juridik është i gatshëm t’ju ndihmojë të kuptoni tregtimin e brendshëm dhe temat përkatëse, si dhe t’ju përgjigjet çdo pyetje që mund të keni.

Respektoni konfidencialitetin dhe të drejtat e pronës

intelektuale të të tjerëve. Mos vidhni sekretet e personave të tjerë, pronën e tyre intelektuale ose pronë tjetër. Kjo zbatohet për gjëra të mëdha si procesi sekret i një kompanie tjetër dhe për gjëra të vogla siç është një imazh me të drejta autori që gjenden në internet.

Bëni kujdes me idetë që nuk i keni kërkuar.

Nëse dikush jashtë kompanisë vjen te ju me një ide që nuk ia keni kërkuar, kontaktoni menjëherë Departamentin Juridik përpara sesa ta përdorni ose ta ndani idenë. Duke e bërë këtë, pakësohet rreziku që një palë e tretë të pretendojë të drejtën për një ide që e kemi tashmë ose të na akuzojë se e kemi vjedhur këtë ide.



MBROJTJA E INFORMACIONIT

Çfarë duhet të mbajmë mend

Konfidenciale apo jo, ajo mbi të cilën punojmë duhet të kalojë provën e gjykimit të mirë etik, ligjit dhe këtij udhëzuesi. Mbani mend se ndërkohë që është e turpshme kur humbet informacioni konfidencial, informacioni vetë nuk duhet të shkaktojë turp. E mbrojmë informacionin për arsye tregtare, ligjore dhe etike - nuk i fshehim gjërat, pavarësisht sa të pakëndshme janë, që njerëzit kanë të drejtën të dinë.

Shkujdesja është shkaku kryesor i humbjes së informacionit.

Nganjëherë është shumë e thjeshtë si për shembull vjedhja e një laptopi apo USB-je të pa-kriptuar, ose një bisedë rreth një çështje konfidenciale në një tren. Herë të tjera është një dëshirë e pamatë për të bashkëpunuar me partnerë të jashtëm, përpara se të jenë vendosur masa të duhura për të mbrojtur informacionin.

Metodat e përdorura për të vjedhur informacionin ndryshojnë gjithnjë.

Teknologjia jonë mund të ndihmojë në mbrojtjen e informacionit, por jeni mbrojtja e vërtetë. Jini skeptikë. Duhet të dini se me kë po punoni dhe mbani mend se impresionimi i punonjësve të PMI-së është një dredhi e preferuar nga kriminelët që përpiqen të vjedhin atë që është e jona.

MËSONI MË SHUMË

PMI 1-C: Menaxhimi i informacionit të kompanisë

PMI 3-C: Mbrojtja e të dhënave personale

PMI 6-C: Të drejtat e Pronës Intelektuale

PMI 17-C: Tregtimi i Brendshëm

PMI 18-C: Përdorimi i Teknologjisë Kompjuterike

PMI 18-CG2: Udhëzimet për mediat sociale

DEKLARATAT DHE TË DHËNAT E KOMPANISË



DEKLARATAT DHE TË DHËNAT E KOMPANISË

Çfarë bëjmë

Komunikojmë me sinqeritet, drejtësi dhe me respekt.

Besimi i publikut te PMI është i rëndësishëm për qëndrueshmërinë afatgjatë të biznesit tonë. Për ta ruajtur këtë besim, të gjitha komunikimet tona të jashtme, zyrtare apo jozyrtare duhet të jenë të vërteta, të përshtatshme dhe jo çorientuese. Ndjekim të njëjtat praktika në komunikimet dhe dokumentet tona të brendshme.

MËSONI MË SHUMË

PMI 1-C: Administrimi i informacionit të kompanisë

PMI 18-CG2: Udhëzimet për mediat sociale

PMI 31-C: Komunikimet me Jashtë dhe Deklaratat Publike

Si e bëjmë këtë

Pasqyrat tona financiare janë të sakta dhe të kuptueshme.

Investuesit duhet të jenë në gjendje të marrin vendime bazuar në atë që themi. Pasqyrat tona financiare dhe informacione të tjera financiare që u japim rregullatorëve dhe publikut duhet të japë një panoramë të kuptueshme dhe të plotë të biznesit tonë. Këshillohuni me zyrën tonë të marrëdhënieve me investuesit përpara se t'i jepni informacion jopublik financiar ose informacion biznesi një pjesëtari të komunitetit të investuesve.

E tregojmë mbështetjen tonë. Jemi transparentë rreth rolit tonë në zhvillimin e materialeve që synojnë të ndikojnë vendimet tona të politikës së interesit të kompanisë. Kjo përfshin rezultatet e punës që kemi financuar në ndikimet e produkteve tona të shëndetit, si dhe kur palët e treta paraqesin të dhëna ose mendime në emrin tonë, të cilat i kemi financuar, për të informuar vendimet e politikës. Nëse njohuritë tuaja për mbështetjen ose përfshirjen tonë financiare në një projekt ose një marrëdhënie me dikë, do të jenë një faktor material për dikë që të vendosë rreth temave përkatëse për kompaninë, atëherë ka shumë mundësi se duhet ta zbulojmë atë.

Ruajmë llogari dhe dokumente të sakta. Mbajtja e llogarive dhe dokumenteve të sakta nuk kufizohet vetëm me pasqyrat tona financiare. Raportimi i çdo informacioni biznesi nga punonjësit dhe kompania duhet të jetë i saktë, i plotë dhe në kohë.

Ruajini të dhënat që kërkohen nga ligji dhe kompania.

Të gjitha filialet kanë një plan që përcakton se cilat dokumente duhet të mbani dhe për sa kohë. Këto plane sigurojnë që biznesi të ketë informacionin që i duhet për të funksionuar dhe që të zbatojmë kërkesat rregullatore. Nëse merrni një Njoftim Ligjor për Ruajtje, duhet të zbatoni udhëzimet në të dhe të ruani të gjithë dokumentet që përshkruhen.

Çfarë duhet të mbajmë mend

Të gjithë e përcaktojmë PMI-në. Vetëm disa prej nesh janë trajtuar dhe autorizuar që të bëjnë deklarata për shtypin, qeverinë ose organet shkencore; por të gjithë ndërveprojmë me publikun. Mbani mend, komunikojmë me sinqeritet dhe nuk bëjmë deklarime që kanë lidhje me shëndetin mbi produktet pa dëshmi shkencore, edhe te familjarët dhe miqtë.

Të njëjtat parime zbatohen për mënyrën sesi komunikojmë brenda korporatës. Jini të ndershëm, të saktë dhe të plotë në komunikimet tuaja të përditshme. Merrni kohën e duhur për të qenë të kuptueshëm. Mos ngatërmoni faktet me opinionin. Nëse do t'ju duhet të ngrini hipoteza rreth një teme, bëjeni të qartë se kjo është pikërisht gjëja që po bëni. Përveç rastit kur është puna juaj, mos bëni vlerësime ligjore ose mos ofroni mendime ligjore në atë që shkruani.

Përdorimi juaj privat i medias sociale nuk është gjithnjë privat. Mos e përdorni median sociale private për të reklamuar ose promovuar markat tona tradicionale ose pa duhan. Ndiqni udhëzimet e kompanisë për përdorimin e mediave sociale. Kuptoni se ajo që thoni nëpërmjet medias sociale është një komunikim publik dhe mund të keqkuptohet si një deklaratë e kompanisë dhe jo mendimet tuaja individuale, ose mund të zbulojë pa dashje informacion konfidencial të kompanisë. Nuk duhet ta çorientojmë publikun ose të shkelim ligjet e investimit ose konfidencialitetit.

INTEGRITETI SHKENCOR



INTEGRITETI SHKENCOR

Çfarë bëjmë

Bëjmë shkencë që njerëzit mund ta vlerësojnë dhe besojnë.

Kërkimi ynë është rreth kuptimit më të mirë të produkteve tona. Kjo është e vërtetë në të tërë spektrin e të gjithë punës tonë shkencore të bërë nga ne dhe për ne. Fokusi i kësaj pjese janë produktet tona pa duhan, por e gjithë puna jonë duhet të jetë rigorozë, transparente dhe objektive.

Besueshmëria e shkencës tonë është thelbësore për pranimin e produkteve tona. E dimë se nëse nuk zbatojmë praktikën më të mirë ose i shpërfillim vlerat e integritetit shkencor, nuk do t'ia dalim me sukses.

Si e bëjmë këtë

Zhvillojmë produkte pa duhan duke përdorur metoda objektive, shumëdisiplinore dhe shkencore. Ndjekim standartet në fuqi dhe parimet e Praktikave të Mira Laboratorike dhe Praktikave të Mira Klinike në projektimin e studimit, interpretimin e të dhënave dhe vlerësimet rregullatore. I udhëheqim metodat e reja të zhvillimit nëse nuk ka të tilla. Përdorim ekspertizën e shkencëtarëve tanë nëpër shumë disiplina për të plotësuar ose tejkaluar kërkesat e autoriteteve rregullatore kërkuese.

Procesi ynë i kontrollit të cilësisë dhe proceset e tjera sigurojnë që të dhënat tona të jenë të sakta dhe të besueshme. Kemi një kuadër të fortë të cilësisë për të kryer kërkimet tona pa duhan gjatë fazave të zhvillimit, vlerësimit, mbikëqyrjes dhe pas publikimit. Nuk i biem shkurt punës sonë shkencore. Sigurohemi që rezultatet e kërkimeve tona të jenë të gjurmueshme dhe të tërheqshme.


Nxisim verifikimin e jashtëm të gjetjeve tona. Kërkimet tona për produktet pa duhan publikohen në revistat ku rishikohen nga shkencëtarë të tjerë dhe i mbështesim konkluzionet tona shkencore duke ndarë publikisht të dhënat tona shkencore. Bashkëpunojmë aktivisht me kërkuesit e jashtëm dhe veprojmë mbi gjetjet e tyre.

Çfarë duhet të mbajmë mend

Hulumtimi ynë bëhet pa presion për të arritur në rezultate specifike. Mënyra jonë e punës nxit të gjithë shkencëtarët tanë të veprojnë në mënyrë të pavarur dhe të shprehin mendimin e tyre rreth çështjeve shkencore. Secili person që punon në një projekt shkencor e ka për detyrë ta bëjë të ditur sjelljen e mundshme të parregullt shkencore.

Njerëzit marrin vendime të rëndësishme bazuar mbi informacionin shkencor që japim. Ndiqni procesin tonë të brendshëm të rishikimit përpara se të komunikoni rezultate shkencore, të lëshoni deklarata të kompanisë ose të bëni deklarime të orientuara nga konsumatori. Kuptoni shkencën pas tyre përpara se të komunikoni çështjet shkencore.

ÇËSHTJET FISKALE DHE TË TREGTISË



ÇËSHTJET FISKALE DHE TË TREGTISË

Çfarë bëjmë

Ndihmojmë në parandalimin e shitjeve të paligjshme të produkteve tona dhe në keqpërdorimin e burimeve të kompanisë tonë.

Një numër i madh duhanpirësish në gjithë botën preferojnë markat tona mbi markat e tjera. Kjo është sigurisht një gjë shumë e mirë, por rrit nxitjen që kriminelët t'i tregtojnë produktet tona si kontrabandë duke shkelur ligjet mbi doganat ose taksat, ose që të përdorin kompaninë tonë për pastrim parash. Standartet e PMI-së janë të qarta: Nuk e falim, lehtësojmë ose mbështesim kontrabandën ose pastrimin e parave. Punojmë me qeveritë për të ndaluar shitjet e paligjshme të produkteve tona. Besueshmëria jonë në këtë fushë varet nga të qenit vigjilent ndaj çdo veprimtarie ose praktike që mund të komprometojë standartet tona.

MËSONI MË SHUMË

PMI 9-C: Njihni shitësit tuaj

PMI 10-C: Njihni klientët tuaj dhe anti-devijimin

PMI 11-C: Format e pranueshme të pagesave

PMI 15-C: Tatimi

Si e bëjmë këtë

Kemi praktika biznesi të hartuara për të parandaluar shfrytëzimin kriminal. Pastrimi i parave është procesi me anë të të cilit individët ose subjektet përpiqen të fshehin burimin e fondeve të paligjshme ose ta bëjnë burimin e fondeve të tyre të paligjshme të duket i ligjshëm. PMI pajtohet me ligjet kundër pastrimit të parave duke përdorur procedura për të shmangur marrjen e parave ose shumës së barasvlershme të parave që kanë ardhur nga krimi. Për të parandaluar kontrabandën, filialet tona mbikëqyrin vëllimet e shitjeve të klientët dhe marrin masa nëse dyshojnë se ka devijim të paligjshëm të produkteve tona.

Kontrollojmë klientë, shitës dhe prodhues të rinj të mundshëm të palëve të treta. Bëjmë biznes vetëm me ata që kanë standartet tona të pajtueshmërisë dhe integritetit. Departamenti i Kontrolleve të Brendshme ka procese për të identifikuar probleme të mundshme me partnerët e biznesit. Kontrollojmë dyfish për t'u siguruar që të mos bëjmë biznes me shtete, regjime, organizata ose individë që i nënshtrohen sanksioneve tregtare të cilat duhet t'i zbatojmë. Ky kontroll duhet të ndodhë përpara angazhimit në një marrëdhënie të re biznesi.

Pajtohemi me kufizimet e anti-bojkotimit. Sipas ligjit të SHBA-së, PMI-së i kërkohet që të raportojë te Qeveria e SHBA-së dhe të mos bashkëpunojmë me asnjë kërkesë që ka të bëjë me bojkote të huaja në kundërshtim me politikën e Qeverisë së SHBA-së. Punonjësit nuk mund të ndërmarrin veprime, të japin informacione ose të bëjnë deklarata që mund të shihen si pjesëmarrje në një bojkot të huaj të paligjshëm. Informacioni aktual mbi bojkotet e ndaluara të huaja ndërkombëtare mund të merret nga Departamenti Juridik.

Çfarë duhet të mbajmë mend

Njihni klientin tuaj dhe standartet e tjera fiskale dhe të tregtisë ju ndihmojnë që t'a bëni punën tuaj më shpejt dhe të na mbani të gjithëve larg telasheve. Praktikë e kompanisë për kontrollin e klientëve dhe palëve të tjera të treta mund të duken të pavolitshme dhe mund të harxhojë kohë, por ndihmojnë biznesin tonë që të funksionojë në mënyrë më efikase dhe të ligjshme. SHBA dhe shtete të tjera kanë kufizime mbi marrëdhëniet me disa shtete e mijëra individë dhe lista ndryshon çdo ditë. Sistemet tona na ndihmojnë të shmangim shkeljet dhe të grumbullojmë informacionin që na duhet për t'u përgjigjur një kërkesë të qeverisë.

KONFLIKTI I INTERESIT, DHURATAT DHE ARGËTIMI



KONFLIKTI I INTERESIT, DHURATAT DHE ARGËTIMI

Çfarë bëjmë

Marrim vendime të drejta dhe objektive.

Konfliktet e interesit ndodhin kur veprimtaritë personale, shoqërore, financiare ose politike bien ndesh me përgjegjësitë e punës së një punonjësi. Shumica e konflikteve të interesit përfshijnë marrëdhënie personale, si për shembull një i afërm që punon për një kompani që përpaket të bëjë biznes me PMI. Vendimet tona të punës duhet të bazohen gjithmonë në çfarë është më e mira për PMI dhe jo për ne personalisht. Një konflikt interesi nuk është domosdoshmërisht problem. Kërkesat tona për konfliktin e interesit nxitin marrjen e vendimeve të drejta duke kërkuar shfaqjen, shqyrtimin dhe lehtësimin e mundshëm të konfliktit që mund të ndikojë objektivitetin tonë profesional. Gjithashtu, rregullat tona për dhuratat dhe argëtimin e ndalojnë marrjen ose ofrimin e çdo gjëje që mund të ndikojë në gjykimin profesional. Kjo do të thotë se mund të mbështetemi te njëri-tjetri për të marrë vendime të mira dhe rrit reputacionin tonë se bëjmë biznes në mënyrë të ndershme.

Si e bëjmë këtë

Bëjini të ditura konfliktet e mundshme të interesit. Jeta juaj private është private. Kompania e respekton këtë, por duhet të dijë nëse ka situata ku interesat tuaja private mund të bien ndesh me përgjegjësitë tuaja profesionale. Duhet t'i tregoni konfliktet e mundshme të interesit pranë Departamentit të Etikës dhe Pajtuëshmërisë, edhe nëse mendoni se mund ta administroni çështjen pa ndihmë. Shumica e njerëzve e mbivlerësojnë aftësinë e tyre për të marrë vendime objektive kur përballen me interesa personale konkurruese. Mënyra më e mirë për të testuar objektivitetin tuaj është që të përfshini të tjerë, të cilët zakonisht mund të gjejnë mënyra për të lehtësuar konfliktin.

Mos ofroni dhurata ose argëtime për të komprometuar gjykimin profesional të të tjerëve. Ofrimi i dhuratave dhe argëtimit është një mënyrë e ligjshme për të krijuar marrëdhënie biznesi dhe për të treguar vlerësimin e duhur. Por dhuratat dhe argëtimi nuk duhet të përdoren për të ndikuar në objektivitetin e njerëzve me të cilët bëjmë biznes. Elementet specifike gjenden në rregullat tona për dhuratat. Përdorni gjithnjë arsyetimin tuaj dhe shmangni gjithçka të tepruar, të pazakontë ose që mund të turpërojë kolegët ose kompaninë tuaj. Mos merrni pjesë në asnjë argëtim që është i pahijshëm ose me orientim seksual. Në përgjithësi ju nevojitet miratim për të dhënë dhurata që kushtojnë më shumë se 250 dollarë amerikanë gjatë një viti kalendarik; filialet mund të vendosin kufij më të ulët.

Mos pranoni dhurata ose argëtime që mund të ndikojnë në objektivitetin tuaj profesional. Mos pranoni asgjë që shkel rregullat e kompanisë për dhuratat ose që mund të turpërojë kolegët dhe kompaninë tuaj. Mund t'ju duhet miratim për të pranuar dhuratat ose argëtimet mbi një nivel të caktuar në një vit kalendarik, prandaj sigurohuni që të kontrolloni praktikat përkatëse të PMI-së ose kufijtë vendorë.

Çfarë duhet të mbajmë mend

Procesi për të bërë të ditur konfliktet e interesit është i thjeshtë, konfidencial dhe i drejtë. Kompania ofron mjete të thjeshta që punonjësit të bëjnë të ditur konfliktet e interesit. Në fakt, shumica e konflikteve të mundshme miratohen, me kushtet e duhura për ata që janë të përfshirë. Vetëm personat e nevojshëm do ta rishikojnë zbulimin nga ju të konfliktit të interesit.

Kush është një familjar i afërm? Një "familjar i afërm" është një partner i jetës, prindërit ose njerku/njerka; fëmijët dhe fëmijët e bashkëshortit/es; vëllezërit dhe motrat; vëllezërit dhe motrat e gjetura; nipërit dhe mbesat; tezet/hallat dhe dajat/xhaxhallarët; gjyshërit/gjyshet; fëmijët e fëmijëve dhe të afërmit e bashkëshortit/es. Rregulli i "familjarit të afërm" mbulon edhe personin me të cilin ju jeni në një marrëdhënie të ngushtë personale. Kontaktoni Departamentin e Etikës dhe Pajtuëshmërisë për udhëzime nëse nuk jeni të sigurt nëse një person është "familjar i afërm".

Mos zbatoni rregullat që kanë të bëjnë me dhuratat kur nuk po jepni një dhuratë. Sigurohuni që të kuptoni se çfarë është një dhuratë. Në angazhimin tonë me vendim-marrësit dhe të tjerët në kontekstin e punës tonë me produktet pa duhan, nganjëherë lëmë pas një pajisje ose një numër të caktuar të pjesëve të konsumueshme që nuk janë për përdorim personal por për sensibilizim ose qëllime testimi. Sigurohuni që të kuptoni rregullat që rregullojnë këto objekte që lihen pas.

Bëni të ditur për raste konflikti interesi

Përdorni [formularin tonë në internet](#) ose kontaktoni drejtpërdrejt Departamentin e Etikës dhe Pajtuëshmërisë. Informoni mbikqyrësin tuaj nëse nuk mendoni se çështja duhet të mbetet e fshehtë.

PËRGJEGJËSIA E ZINXHIRIT TË FURNIZIMIT



PËRGJEGJËSIA E ZINXHIRIT TË FURNIZIMIT

Çfarë bëjmë

Jemi të angazhuar për një rritje afatgjatë.

Arritja e një rritje afatgjatë varet nga qëndrueshmëria e zinxhirëve tanë të brendshëm dhe të jashtëm të furnizimit. Po e ulim ndikimin e veprimtaritë tona mbi mjedisin dhe po nxisim qëndrueshmërinë e burimeve natyrore nga të cilat varem.

Jemi të ndjeshëm ndaj dhe punojmë për të trajtuar shqetësimet në lidhje me punën e fëmijëve dhe punën e detyruar. Këto veprime përmirësojnë rezultatet tona të biznesit dhe përmirësojnë jetën e njerëzve në komunitetet ku punojmë.

MËSONI MË SHUMË

Kodi i PMI-së për Praktikën e Punës në Bujqësi

PMI 8-C: Mjedisi, shëndeti, mosrrezikshmëria dhe siguria

PMI 12-C: Kontributet Bami-rëse

Parimet e Burimeve të Përgjegjshme të PMI-së

Si e bëjmë këtë

Vazhdojmë të pakësojmë gjurmët tona të karbonit. Kemi objektiva vjetore, pesëvjeçare dhe njëzetvjeçare për të ulur gjurmët e karbonit në zinxhirin tonë të furnizimit. Nismat tona mbulojnë qëndrueshmërinë në prodhimin bujqësor, përfshirë shpyllëzimin, konsumin e energjisë dhe të ujit, riciklimin dhe emetimet e CO₂. Tregojmë ecurinë tonë çdo vit.

Po punojmë që të eliminojmë punën e fëmijëve, punën me detyrim dhe abuzime të tjera me punë në zinxhirin tonë të furnizimit. Nuk e falim punën e fëmijëve dhe punën e detyruar dhe nuk punësojmë fëmijë ose punë të detyruar në kompaninë tonë. Angazhohemi me fermerët për praktika të mira bujqësore për të përmirësuar qëndrueshmërinë e prodhimit të tyre. Presim që fermerët të zbatojnë kërkesat e Kodit tonë të Praktikave të Punës në Bujqësi. Programet tona të bami-rësisë ndihmojnë në krijimin e mundësive për komunitetet rurale.

Presim që furnizuesit tanë të zbatojnë Parimet e Burimeve të Përgjegjshme në mënyrë të kujdesshme dhe transparente. Në PMI, jemi

angazhuar të bëjmë biznes në pajtim me parimet e njohura ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, menaxhimin e mjedisit, integritetin e biznesit dhe anti-korrupsionin. Besojmë se përpjekjet e përbashkëta me furnizuesit tanë për të krijuar një zinxhir më të qëndrueshëm furnizimi do të ofrojnë shumë mundësi për të forcuar marrëdhëniet tona të biznesit dhe për të krijuar vlera për kompanitë tona përkatëse.

Çfarë duhet të mbajmë mend

Punojmë me furnizuesit që kanë të njëjtin angazhim si ne për pajtueshmërinë dhe integritetin. Reputacioni dhe biznesi ynë ndikohen nga ata që zgjedhim për të punuar në zinxhirin tonë të furnizimit dhe nga mënyra sesi punojnë partnerët dhe furnizuesit tanë. Nëse po zgjidhni një furnizues të ri ose po rivlerësoni një furnizues të tanishëm, sigurohuni se ata i kuptojnë parimet tona dhe jini vigjilent ndaj çdo gjëje që mund të komprometojë standartet tona.

PËRGJEGJËSITË E PËRGJEGJËSIT



PËRGJEGJËSITË E PËRGJEGJËSIT

Kultura e organizatës tonë ndikon në veprimet tona.

Shumë faktorë krijojnë kulturë korporate. Për shembull, mënyra sesi punojmë së bashku si ekip, reputacioni ynë për sinqeritet, drejtësia e organizatës, respekti që i tregojmë njëri-tjetrit dhe klientëve, perceptimi i politikave të korporatës, presioni i konkurrencës edhe thashethemet e vogla kontribuojnë të gjitha për të mirë ose për të keq në kulturën e korporatës tonë. Ata që kompania i beson të mbikëqyrin të tjerët kanë përgjegjësi të veçantë për të formuar kulturën e korporatës tonë dhe mjedisin e punës së ekipeve të tyre.

**Të gjithë
përgjegjësit duhet
të sigurohen që
ekipet e tyre:**

Ta dinë dhe ta kuptojnë këtë Udhëzues dhe Parimet dhe Praktikën e PMI-së lidhur me punën e tyre.

Ta kuptojnë se ky Udhëzues dhe Parimet dhe Praktikën e PMI-së zbatohen me drejtësi dhe konsekuencë.

Janë të lirë të ngrenë probleme të etikës dhe pajtueshmërisë dhe të presin që kompania t'i dëgjojë shqetësimet e tyre.

Shikojnë se ne bëjmë biznes me integritet, duke treguar ndershmëri, drejtësi dhe respekt.

Ruajtja e kulturës së duhur është shumë më e vështirë sesa thjesht t'u thuhet punonjësve që të ndjekin rregullat. Mbi të gjitha, nevojitet udhëheqje e mirëfilltë. Tregoni se çfarë do të thonë të veproni me integritet. Fitoni besimin e ekipit tuaj duke folur rreth temave në këtë Udhëzues. Bëni pyetje, dëgjoni dhe veproni për çfarë thonë ata.

Mbikëqyrja e të tjerëve kërkon kurajo. Konsekuenca dhe besueshmëria janë të lidhura ngushtë. Mbani mend se të qenit udhëheqës nuk do të thotë që të mbani shumicën të kënaqur apo të kënaqni një anëtar veçanërisht të vështirë të ekipit; do të thotë të frymëzoni të tjerët të ndjekin, krijojnë një ndjesi komuniteti dhe sfiduese në mënyrë konstruktive.

Nëse dikush ngre një problem rreth sjelljes së pahijshme të dyshuar, kini parasysh se po respekton detyrën e tij si punonjës dhe duhet të trajtohet me respekt. Ju lutemi mos hetoni vetveten. Kontaktoni menjëherë Etikën dhe Pajtueshmërinë për këto çështje, në mënyrë që kompania të mund ta trajtojë shqetësimin me objektivitet.

Besimi duhet të jetë i dyanshëm. Nëse mendoni se përgjegjësi juaj duhet të bëjë më shumë për të ndërtuar një kulturë etike dhe pajtueshmërie, atëherë thuajini përgjegjësit ose të tjerëve në kompani.

ZBATUESHMËRIA DHE ZGJIDHJA

Ky Udhëzues përmban dispozita të detyrueshme që zbatohen për të gjithë punonjësit, nëpunësit dhe drejtorët e PMI-së dhe për këdo që bën biznes në emrin tonë. Shkelja e këtij Udhëzuesi ose e Parimeve dhe Praktikave të Pajtueshmërisë mund të rezultojë në disiplinim, përfshirë largimin nga puna.

Asnjë dispozitë e këtij Udhëzuesi nuk mund të zgjidhet pa miratimin e Bordit të Drejtuesve.

Ky Udhëzues zbatohet për Philip Morris International Inc. dhe filialet e drejtpërdrejta ose jo të drejtpërdrejta, së bashku të referuara si Philip Morris International, PMI ose kompania.

© Philip Morris International Management SA

